

## Marreveshje Transferimi Kuote si Kontribut ne Kapital

(ne vijim, “**Marreveshje Transferimi Kuote**”)

Sot, me date 12.07.2023, lidhet kjo Marreveshje Transferimi Kuote midis paleve te meposhtme:

- **Z. Arbër Veliaj**, shtetas shqiptar, lindur më 25.12.1985, në Tiranë, me banim ne adresën: “Rruga Manol Konomi, Nd. 12, H. 1, Njësia Administrative nr. 2, Kodi Postar 1017; Tiranë”, e-mail: *arbi.veliaj@gogel.al*, mbajtës i pasaportës me numër personal: I51225008D (ne vijim, “**Transferuesi i Kuotes**”)

dhe

- **GOGEL HOLDINGS Shpk**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe ekzistuese në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare të Biznesit, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): M31911003I, me seli në adresën: “Rruga Pjetër Bogdani, Ndërtesa Rainbow Center, Kati 2, Njësia Bashkiake nr. 8, Tiranë, Shqipëri” (ne vijim, “**Perfituesi i Kuotes**”), e perfaqesuar nga administratori i saj z. Ildir Themeli.

Transferuesi i Kuotes dhe Perfituesi i Kuotes, ne vijim, se bashku referuar si “**Palet**” dhe veçmas si “**Pala**”.

### Megjenese:

- A. Transferuesi i Kuotes eshte ortak i vetem i shoqerise GOGEL Shpk, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me seli në adresën: “Rruga Gjik Kuçali, Qendra e Biznesit Gold, 1/21, Tiranë”, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): K91621020U (ne vijim, “**GOGEL**”);
- B. Gjithashtu, Transferuesi i Kuotes eshte ortak i vetem i Perfituesit te Kuotes, e cila eshte nje shoqeri e themeluar me qellim qe te operoje ne rolin e shoqerise kontrolluese (*holding*) te grupit te shoqerive qe zoteron Transferuesi i Kuotes (perfshire, ketu, GOGEL);
- C. Ne vendimin e dates 12.07.2023, Transferuesi i Kuotes, ne cilesine e ortakut te vetem te GOGEL, ka vendosur kalimin e kuotes qe ai zoteron ne kapitalin e shoqerise, kuote e cila perben 100% (*njeqind perqind*) te kapitalit te saj, ne perputhje me vleren nominale te kesaj kuote te barabarte me 9.800.000 (*nente milione e teteqind mije*) Leke, siç reflektohet ne Regjistrin Tregtar (ne vijim, “**Vendimi i Ortakut te Vetem te GOGEL**”);
- D. Bazuar ne sa parashtruar me siper, Perfituesi i Kuotes, ne vendimin nr. 2/2023, date 12.07.2023, te ortakut te vetem te saj (i cili eshte Transferuesi i Kuotes), ka vendosur zmadhimin e kapitalit te saj, nepermjet pranimet te kalimit te kuotes qe

ortaku i vetem (Transferuesi i Kuotes) zoteron ne GOGEL, me vlere nominale te barabarte me 9.800.000 (*nente milione e teteqind mije*) Leke, siç reflektohet ne Regjistrin Tregtar (ne vijimi “**Vendimi i Ortakut te Vetem te Perfituesit te Kuotes**”);

- E. Bazuar ne sa parashtruar ne germat “A” deri “D” me siper, Palet deshirojne te lidhin kete Marreveshje Transferimi Kuote.

**BAZUAR NE SA ME SIPER**, Palet bien dakord me kushtet dhe afatet si vijon:

## **Neni 1**

### **Transferimi i kuotes**

- 1.1 Sipas kushteve te percaktuara ne Vendimin e Ortakut te Vetem te GOGEL (bashkelidhur ne Aneksin 1 te kesaj Marreveshje Transferimi Kuote si pjese integrale e saj), si dhe ne Vendimin e Ortakut te Vetem te Perfituesit te Kuotes (bashkelidhur ne Aneksin 2 te kesaj Marreveshje Transferimi Kuote si pjese integrale e saj), Transferuesi i Kuotes i transferon Perfituesit te Kuotes, si kontribut ne kapitalin e ketij te fundit, 1 (nje) kuote qe ai zoteron ne kapitalin e GOGEL, me vlere nominale 9.800.000 (*nente milione e teteqind mije*), e cila perben 100% (*njeqind perqind*) te kapitalit te GOGEL.
- 1.2 Ne vijim te transferimit te kuotes, ortaku i vetem i GOGEL do te jete Perfituesi i Kuotes, i identifikuar si me poshte vijon:
- **GOGEL HOLDINGS Shpk**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe ekzistuese në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare të Biznesit, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): M31911003I, me seli në adresën: “*Rruga Pjetër Bogdani, Ndërtesa Rainbow Center, Kati 2, Njësia Bashkiake nr. 8, Tiranë, Shqipëri*”, zotuese e nje kuote ne para, me vlere nominale 9.800.000 (*nente milione e teteqind mije*) Leke, qe perkon me 100% (*njeqind perqind*) te kapitalit te GOGEL.

## **Neni 2**

### **Deklarata dhe garanci te Paleve**

- 2.1 Palet bien dakord qe kalimi i pronesise mbi kuoten e zoteruar nga Transferuesi i Kuotes ne kapitalin e GOGEL, eshte efektiv nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar, te mbajtur nga Qendra Kombetare e Biznesit, te Vendimit te Ortakut te Vetem te GOGEL.
- 2.2 Palet bien dakord qe kalimi i kuotes, se zoteruar nga Transferuesi i Kuotes ne kapitalin e GOGEL, si kontribut ne kapitalin e Perfituesit te Kuotes, i barabarte me vleren nominale te kuotes siç reflektohet ne Regjistrin Tregtar; konkretisht: 9.800.000 (*nente milione e teteqind mije*) Leke.

- 2.3 Transferuesi i Kuotes eshte zoterues i kuotes qe transferohet, e cila eshte e lire nga çdo barre apo pretendim i te treteve mbi te, dhe ka te drejte ta transferoje ate siç parashikohet ne kete Marreveshje Transferimi Kuote dhe aktet bashkelidhur saj.
- 2.4 Nenshkrimi i kesaj Marreveshje Transferimi Kuote, nga ana e Transferuesit te Kuotes, nuk eshte ne konflikt apo kundersiztim me ndonje marreveshje apo detyrim tjeter te Transferuesit te Kuotes.
- 2.5 Nenshkrimi i kesaj Marreveshje Transferimi Kuote, nga ana e Perfituesit te Kuotes, nuk eshte ne konflikt apo kundersiztim me ndonje marreveshje apo detyrim tjeter te Perfituesit te Kuotes

### Neni 3

#### Dispozita te pergjithshme

- 3.1 Kjo marreveshje rregullohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3.2 Te gjitha mosmarreveshjet lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kesaj marreveshjeje do te shqyrtohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.
- 3.3 Kjo marreveshje hartohet ne 2 (dy) kopje origjinale, me vlere te njejte ligjore secila.

#### Transferuesi i Kuote



Arbër Veliaj



#### Per Perfituesin e Kuotes

(GOGEL HOLDINGS Shpk)



Idlir Themeli

Administrator

## **Aneksi 1 – Vendimi i Ortakut te Vetem te GOGEL**

### **Vendim i ortakut të vetëm të shoqërisë GOGEL SHPK**

Sot, më 12.07.2023, ortakut i vetëm i shoqërisë GOGEL Shpk, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me seli në adresën: “*Rruga Gjok Kuqali, Qendra e Biznesit Gold, 1/21, Tiranë*”, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): K91621020U (në vijim, “**Shoqëria**”), vendosi si vijon:

#### **MEQENËSE**

- (i) Ortaku i vetëm i Shoqërisë (Arbër Veliaj) është gjithashtu ortak i vetëm i shoqërisë GOGEL HOLDING SHPK, një shoqëri e regjistruar në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me seli në adresën: “*Rruga Pjetër Bogdani, Ndërtesa Rainbow Center, Kati 2, Njesia Bashkiake nr. 8, Tiranë*”, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): M31911003I (në vijim, “**GOGEL HOLDINGS**”), e cila është themeluar me qëllim që të operojë në rolin e shoqërisë kontrolluese (*holding*) të shoqërive që zotëron ortakut i vetëm i saj.
- (ii) Ortaku i vetëm i Shoqërisë dëshiron të riorganizojë grupin e shoqërive të zotëruara në përputhje me pikën 1 më sipër dhe, për këtë qëllim, dëshiron që kuotën e zotëruar në Shoqëri ta vendosë si kontribut në kapitalin e GOGEL HOLDINGS Shpk.

**SA MË SIPËR**, ortakut i vetëm i Shoqërisë vendosi si vijon:

#### **VENDIM:**

1. Kalimin e kuotës që ortakut i vetëm zotëron në Shoqëri, e cila përbën 100% (*njëqind përqind*) të kapitalit të saj (me vlerë nominale 9.800.000 (*nëntë milionë e tetëqind mijë*) Lekë), si kontribut në kapitalin e GOGEL HOLDINGS Shpk.

Kuota e ortakut të vetëm kalon në formën e kontributit në kapitalin e GOGEL HOLDINGS Shpk, në përputhje me vlerën e saj nominale, siç është aktualisht e regjistruar në Regjistrin Tregtar;

2. Bazuar në pikën 1 më sipër, me efekt nga data e regjistrimit të këtij vendimi në Regjistrin Tregtar, ortak i vetëm i Shoqërisë do të bëhet GOGEL HOLDING Shpk;
3. Si pasojë e sa parashikuar në pikat 1 dhe 2 më sipër, nenet 7 dhe 8 të statutit të Shoqërisë ndryshojnë si vijon:

**“Neni 7 Kapitali**


*Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 9.800.000 (nëntë millionë e tetëqind mijë) Lekë, i përbërë nga 1 (një) kuotë e vetme, me një vlere nominale të barabartë 9.800.000 (nëntë millionë e tetëqind mijë) Lekë, e cila përkon me 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë, si dhe e cila është e nënshkruar dhe krejtësisht e shlyer, si kontribut në para, nga ortakut i treguar në nenin 8 të këtij statuti.*

**Neni 8 Ortakut i Shoqërisë dhe kuota e zotëruar prej ortakut**

*Kapitali i Shoqërisë zotërohet tërësisht nga Ortakut i vetëm si vijon:*

- **GOGEL HOLDINGS Shpk**, një shoqëri e regjistruar në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me seli në adresën: “Rruga Pjetër Bogdani, Ndërtesa Rainbow Center, Kati 2, Njesia Bashkiake nr. 8, Tiranë”, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): M31911003I, zotëruese e 1(një) kuote në para, me vlerë nominale 9.800.000 (nëntë millionë e tetëqind mijë) Lekë, cila përkon me 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë.”.
4. Përditësimin e statutit të Shoqërisë, në përputhje me pikat 1 deri 3 të këtij vendimi, si dhe depozitimin e vendimit dhe statutit të përditësuar në Regjistrin Tregtarë;
  5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Ortakut i vetëm**

  
**Arber Veliaj**

**Aneksi 2 – Vendimi i Ortakut të Vetëm të Perfituesit të Kuotes**

**Vendim nr. 2/2023**  
**i ortakut të vetëm**  
**të GOGEL HOLDINGS SHPK**

Sot, më 12.07.2023, ortaku i vetëm i shoqërisë GOGEL HOLDINGS Shpk, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me seli në adresën: “*Rruga Pjetër Bogdani, Ndërtesa Rainbow Center, Kati 2, Njesia Bashkiake nr. 8, Tiranë*”, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): M31911003I (në vijim, “**Shoqëria**”), vendosi si vijon:

**VENDIM:**

**MEQENËSE:**

- (i) Ortaku i vetëm i Shoqërisë (Arbër Veliaj) është gjithashtu ortak i vetëm i shoqërisë GOGEL SHPK, një shoqëri e regjistruar në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me seli në adresën: “*Rruga Gjik Kuqali, Qendra e Biznesit Gold, 1/21, Tiranë*”, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): K91621020U (në vijim, “**GOGEL**”);
- (ii) Me vendimin e datës 12.07.2023, ortaku i vetëm i GOGEL, në kuadër të riorganizimit të grupit të shoqërive që ai zotëron, ka vendosur të kalojë kapitalin e GOGEL në kapitalin e Shoqërisë, si kontribut në kapital, në përputhje me vlerën nominale të regjistruar në Regjistrin Tregtar.

**SA MË SIPËR**, ortaku i vetëm i Shoqërisë vendosi si vijon:

**VENDIM:**

1. Zmadhimin në natyrë të kapitalit të Shoqërisë, nëpërmjet pranimit të kalimit të kuotës që ortaku i vetëm i Shoqërisë zotëron në kapitalin e GOGEL.  
Zmadhimi i kapitalit në natyrë përkon me vlerën nominale të kuotës që ortaku i vetëm zotëron në shoqërinë GOGEL, e barabartë me 9.800.000 (*nëntë milionë e tetëqind mijë*) Lekë, siç reflektohet në Regjistrin Tregtar;
2. Bazuar në pikën 1 më sipër, kapitali i Shoqërisë, nga 100.000 (*njëqind mijë*) Lekë, bëhet **9.900.000 (nëntë milionë e nëntëqind mijë) Lekë**;

3. Si pasojë e sa parashikuar në pikat 1 dhe 2 më sipër, neni 8 i statuti të Shoqërisë ndryshon si vijon:

**“NENI 8**

**Kapitali i regjistruar dhe kuotat**

8.1 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 9.900.000 (nëntë milionë e nëntëqind mijë) Lekë, i cili është i përbërë nga kontributet si vijon:


- (i) Kontributi në para, në vlerën e barabartë me 100.000 (njëqind mijë) Lekë;
- (ii) Kontributi në natyrë, i përbërë nga 100% të kuotave të shoqërisë GOGEL SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me seli në adresën: “Rruga Gjik Kuqali, Qendra e Biznesit Gold, 1/21, Tiranë”, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): K91621020U, i cili përkon me vlerën nominale në para të barabartë me 9.800.000 (nëntë milionë e tetëqind mijë) Lekë.

8.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet 100% (njëqind përqind), si dhe është nënshkruar dhe shlyer tërësisht, nga Ortaku si vijon:

- **Z. Arbër Veliaj**, zotërues 1 (një) kuotë, me vlerë 9.900.000 (nëntë milionë e nëntëqind mijë) Lekë, e cila përkon me 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë.”.

Bashkëlidhur këtij vendimi gjendet statuti i përditësuar i Shoqërisë;

- 4. Me regjistrimin e këtij vendimi në Regjistrin Tregtar, Shoqëria bëhet ortak i vetëm i GOGEL SHPK;
- 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ORTAKU  
  
\_\_\_\_\_  
Arbër Veliaj

